



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / PUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. Prot No <u>01-691/13</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>07-03-2013</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit. Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.02.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr. AKK– 03-2439/12, për z.Flamur Keqa, Anëtar i Bordit në Kompaninë Elektorenergjetike të Kosovës (KEK), për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lendes me numër protokolli AKK–03-2439/12, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z. Flamur Keqa, Anëtar i Bordit në Kompaninë Elektorenergjetike të Kosovës (KEK).

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Anëtar i Bordit në Kompaninë Elektorenergjetike të Kosovës (KEK), është i angazhuar edhe në një tjetër funksion publik si Drejtor I Departamentit të Tregtisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 23.08.2012, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Flamur Keqa, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe ti bisedojmë rreth çështjes së ngritur, pas kësaj është organizuar takimi me z. Keqa, ku dhe i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtari në fjalë na ka

njoftuar se ka qenë duke ushtruar funksionin e Drejtorit të Departamentit të Tregtisë, në Ministrinë e Tregtisë dhe njëkohësisht e ushtron edhe pozitën e anëtarit të bordit në Kompaninë Elektroenergjitike të Kosovës (KEK), ku është emëruar sipas konkursit publik, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjatë prezantimit të provave dhe argumenteve, zyrtari në fjalë është arsyetuar se, pozitën e drejtorit të Departamentit në Ministrinë e Tregtisë, nuk është duke e ushtruar pasi që është pezulluar me një vendim arbitrar kundërligjorë nga sekretarja e kësaj Ministrie, dhe e thekson se pozita si Drejtor nuk ka role vendimmarrës, që mund të shkaktoj situatë të konfliktit të interesit me funksionin si anëtar i bordit në Kompaninë Elektroenergjitike të Kosovës (KEK), dhe nuk mendon që gjendet në situatë që mund të shkaktoj konfliktit të interesit, pasi që në funksionin si anëtar bordit nuk ka rol vendimmarrës dhe ekzekutiv, dhe nuk merr pagë të rregullt por paguhet sipas mbledhjeve të bordit si lloj mëditje për takime, sipas ligjit në fuqi, dhe mandati i anëtarëve të bordit është me mandat të skaduar por i vazhduar me një vendim deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj.

Duke u bazuar në, gjendjen aktuale, si dhe në provat dhe dëshmitë e ofruara nga zyrtari në fjalë si dhe duke u bazuar në përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive në punë, si dhe duke u bazuar në ligjin mbi Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 dhe Ligjin Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 15 pika 2, ku thotë se (Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organit drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike apo shoqërisë aksionare me pronë publike, mirëpo nuk ka të drejtë kompensimi me pagë të rregullt, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme).

Konstatohet se: ushtrimi i funksionit si Drejtor i Departamentit të Tregtisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë i cili funksion është i pezulluar me një vendim, dhe gjendet në proces gjyqësorë pas ankesës së bërë, dhe angazhimit të tij si anëtar i bordit në Kompaninë Elektroenergjitike të Kosovës (KEK), në këtë periudhë nuk paraqesin mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, dhe nuk shkaktojnë gjendjen e konfliktit të interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

